

VENDIM
Nr. 84, datë 7.6.2017

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË
“DITEKO” SHPK PËR BARRËSIMIN E ASETEVE TË KOMPANISË (PAJISJET
ELEKTROMEKANIKE) NË FAVOR TË BANKËS KOMBËTARE TREGTARE SHA**

Në mbështetje të neneve 16; 44, pika 1 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe në zbatim të neneve 6; 7 dhe 8 të “Rregullores për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 119, datë 21.7.2016; pikës 1.3 dhe 1.6 të “Licencës për prodhimin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 99, datë 17.6.2016, gjithashtu dhe neneve 15 dhe 19 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 7.6.2017, mbasi shqyrtoi relacionin mbi fillimin e procedurave për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Diteko” sh.p.k., për barrësimin e aseteve të kompanisë (pajisjet elektromeکانike) në favor të Bankës Kombëtare Tregtare sh.a., të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Diteko” sh.p.k. plotëson pjesërisht kërkesat e parashikura nga ERE në “Rregulloren për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit”, si më poshtë:

- Neni 7, pika 1, germat:

- “a” Një ekstrakt historik i shoqërisë tregtare të të licencuarit, të lëshuar jo më vonë se 3 muaj nga data e aplikimit: plotësuar.

- “b” Veprimtaria e licencuar: plotësuar. (Subjekti është i licencuar nga ERE në aktivitetet e prodhimit dhe tregtimit të energjisë elektrike.)

- “c” Gjendja financiare e kompanisë në kohën që paraqet kërkesën dhe efektin e pritshëm pas miratimit të transferimit të aseteve: plotësuar. (Subjekti ka paraqitur bilancin dhe pasqyrat financiare për vitin 2016.)

- “d” Një përshkrim të kandidatit të propozuar për transferim aset, që përfshin informacion të përgjithshëm mbi veprimtarinë e shoqërisë që përfshihet në transaksion të tre viteve të fundit dhe të vitit të fundit, kur shoqëria ka më pak se 3 vjet që është krijuar, gjendjen financiare: Banka që do të barrësojë asetet e shoqërisë “Diteko” sh.p.k. është Banka Kombëtare Tregtare (BKT).

- “e” Arsyet e kërkesës për kryerjen e transferimit janë: Financimi i finalizimit të hidrocentraleve të shoqërisë “Diteko” sh.p.k. dhe/ose lëvrimin e letër-kredive për blerjen e turbinave të hidrocentraleve të “Diteko” sh.p.k., dhe/ose kontratave të furnizimit e blerjes për materiale/pajisje në funksion të ndërtimit të hidrocentraleve.

- “f” Efektet e pritshme të transferimit në aktivitetin e të licencuarit: Vendosja në operim e veprave në fund të vitit. Shpjeguar nga subjekti në kërkesën drejtuar ERE-s për barrësim.

- “g” Efekti në furnizimin e rregullt e të qëndrueshëm të klientëve të të licencuarit dhe në tarifat e aktivitetit të licencuar: pa plotësuar.

- “h” Marrëveshje paraprake e nënshkruar midis palëve në një nga format e parashikuara nga ligji, për transferimin e aseteve. Marrëveshja duhet të përmbajë një listë të detajuar të aseteve që kërkohet të transferohen. Subjekti ka paraqitur si më poshtë:

Kontratën e kredisë bankare, nr. 1347 Rep., nr. 313 Kol., datë 3.3.2017, lidhur midis shoqërisë “Diteko” sh.p.k., dhe Bankës Kombëtare Tregtare sh.a.

- “i” Deklaratë me shkrim e personit tek i cili është propozuar të bëhet transferimi, ku të shprehet gatishmërinë e tij për të garantuar vetë apo me palë të tjera veprimtarinë e licencuar pas kryerjes së transferimit: Nuk rezulton të jetë depozituar asnjë deklaratë ku të shprehet gatishmëria për të garantuar

veprimtarinë e licencuar nga personi tek i cili është propozuar të bëhet transferimi.

-“j” Nëse ka pasur, listën e transferimeve të kryera me herët nga i njëjti subjekt: Nga përmbajtja e kontratës së kredisë bankare që subjekti “Diteko” sh.p.k. ka depozituar në ERE, subjekti në cilësinë e kredimarrësit kundrejt limitit total të kreditimit dhënë nga Banka Kombëtare Tregtare e siguron këtë të fundit me anë të garancisë përfaqësuar nga:

- Kontrata e hipotekës nr. 3538 Rep., nr. 910 Kol., datë 11.7.2014.
- Marrëveshja siguroese (në formën e pengut mbi pajisjet dhe makineritë) nr. 2421 Rep., nr. 1416 Kol., datë 7.9.2015.
- Marrëveshje pengut mbi kredi/të drejta nr. 2437 Rep., nr. 1427 Kol., datë 8.9.2015.
- Marrëveshje siguroese (në formën e pengut të të ardhurave të arkëtueshme) nr. 2438 Rep., nr. 1428 Kol., datë 8.9.2015.
- Kontrata e hipotekës nr. 5698 Rep., nr. 1097 Kol., datë 7.10.2015.
- Marrëveshje pengut mbi kredi/të drejta nr. 5693 Rep., 1092 Kol., datë 7.10.2015.
- Marrëveshja siguroese (në formën e pengut të të ardhurave të arkëtueshme) nr. 5694 Rep., nr. 1093 Kol., datë 7.10.2015.
- Marrëveshje pengut (mbi kuotat e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar) nr. 5695 Rep., 1094 Kol., datë 7.10.2015.
- Marrëveshje pengut mbi kredi/të drejta nr. 4337 Rep., nr. 2332 Kol., datë 2.9.2016.
- Marrëveshja siguroese (në formën e pengut të të ardhurave të arkëtueshme) nr. 4338 Rep., nr. 2333 Kol., datë 2.9.2016.

- Kontrata e hipotekës nr. 1348 Rep., nr. 314 Kol., datë 3.3.2017.
- Marrëveshja siguroese (në formën e pengut të të ardhurave të arkëtueshme) nr. 1351 Rep., nr. 317 Kol., datë 3.3.2017.
- Marrëveshje siguroese (mbi kuotat e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar) nr. 1350 Rep., nr. 316 Kol., datë 3.3.2017.
- Marrëveshje siguroese (në formën e barrës siguroese mbi makineritë dhe turbinat e hidrocentraleve të shoqërisë “Diteko” sh.p.k), të cilat do të nënshkruhen në një fazë të dytë me nënshkrimin e kësaj kontrate.

- Neni 7, pika 3. Subjektet koncesionare të licencuara, të cilat aplikojnë për miratimin e transferimit të aseteve në ERE, duhet të shprehin në formë të shkruar në marrëveshjen e transferimit të aseteve detyrimet me të cilat ngarkohen për shkak të marrëveshjes së koncensionit e pjesët që transferojnë te përfituesi. Kjo përfshin edhe informimin e Autoritetit Shtetëror në lidhje me qëllimin e transferimit të aseteve. Nuk rezulton nga dosja që subjekti të ketë depozituar në ERE miratimin e MEI-t për këtë barrësim asetesh.

Për mungesën e dokumentacionit të sipërcituar do të njoftohet subjekti që, në bazë të nenit 11, pika 1 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, t’i paraqesë këto në ERE brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Diteko” sh.p.k. për lënien peng të aseteve që i shërbejnë aktivitetit për të cilin është licencuar, në favor të Bankës Kombëtare Tregtare sh.a.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti